VENDIM
Nr.123, datë 28.3.2011

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA "FOKUS CABLE" SHPK

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira	Bushati	kryetare
Alban	Karapici	zëvendëskryetar
Suela	Musta	anëtare
Sami	Neza	anëtar
Gent	Ibrahimi	anëtar (në mungesë)
Zylyftar	Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria "Fokus Cable" sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr.4, datë 21.1.2011 të KKRT-së.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullorja "Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, neneve 121, 124 e 135 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.4, datë 21.1.2011, ka vendosur të mos miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor "TV kabllor Fokus" për komunën Pirg, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se të dhënat mbi kapitalin financiar ishin paraqitur me anë të listës së pajisjeve të transmetimit në masën 10.790.000 lekë (ndërkohë që vlera e kapitalit financiar është kërkuar në vlerën jo më pak se 20 milionë lekë) dhe subjekti nuk kishte paraqitur garancinë bankare në masën 10% të kapitalit shtesë.

Me shkresën nr.339 prot., datë 23.2.2011, subjekti është ankuar ndaj këtij vendimi duke kërkuar rishikimin e tij dhe miratimin e zgjerimit të zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor "TV kabllor Fokus".

Nga shqyrtimi i aplikimit të subjektit "Fokus Cable" sh.p.k., rezulton se kapitali themeltar është paraqitur në vlerën 10.790.000 lekë. Në rregulloren "Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, në pikën 7 janë parashikuar kushtet financiare për dhënien e licencës, dhe rezulton se "2. Për transmetimet radio apo televizive me kabllo, licenca u jepet vetëm subjekteve që kanë kapital të vërtetuar në masën jo më pak se 10 milionë lekë.", kusht, i cili është përmbushur nga ana e subjektit aplikues për zgjerim zone.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen kërkesën e shoqërisë "Fokus Cable" sh.p.k., të drejtë e të mbështetur në ligj,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, neneve 121, 124 dhe 135 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave

Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Revokimin e vendimit nr.4, datë 21.1.2011 “Për moszgjerimin e zonës së licencimit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “TV kabllor Fokus”.

3. Zgjerimin e zonës së licencimit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus”, në komunën Pirg.

4. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjithë kushteve të saj.

5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati